

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Auron Tare: "Kino Ditar"-i i qeverisë për Butrintin, propagandë për të fshehur realitetin
ADRESA	https://tpz.al/auron-tare-kino-ditar-i-i-qeverise-per-butrintin-propagande-per-te-fshehur-realitetin-i333991
BURIMI	tpz.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 12:28:33 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 12:23:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f6066aff6c792f1cac9b6763e652180f966242549e26c227a51b17295dc565da
TEKSTI	5fb9367ba6db5d5c0588add1e3d5d36b8ad0f84c3d8e5da16a8e0a5c888282f4
PAMJA	1f0cd8f47387a249412729f9e3fe720b96d8f6e6a5a67a90382910b6c88385d6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b8d46239130aa6c06aabb63fef453eb836d57832285daf325d5357712bcc604
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	8943aae4786784478314ed8f36e25f0bd32ee36cc85ad3e80ac7b853175904e3
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b8d46239130aa6c06aabb63fef453eb836d57832285daf325d5357712bcc604>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

FLASH!

12:55 Ish-deputeti Azgan Haklaj ndalohet në kufirin e Bilatës, Magedonia e Veriut e ka futur në "Stop-listë" • 12:20 "A do të lajmërojë dorëheqjen Rama?", Salianji: Në New Yo

AKTUALITET, 27 SEPTEMBER 2026, 14:23

Auron Tare: "Kino Ditar"-i i qeverisë për Butrintin, propagandë për të fshehur realitetin

tpz.al TPZ



Studiuesi Auron Tare ka kritikuar qeverinë për mënyrën se si administrohet Parku Kombëtar i Butrintit, duke e cilësuar një video të publikuar në Instagramin e Kryeministrit si "Kino Ditari" propagandistik.

Tare ngre pikëpyetje mbi gjendjen e monumenteve, mbrojtjen e territorit dhe mënyrën se si administrohen të ardhurat e krijuara nga Parku i Butrintit.

Sipas tij, pamjet promovuese fokusohen te disa ndërhyrje në qytetin antik, ndërsa lënë jashtë problematikat e zonave arkeologjike dhe natyrore përreth. Ai kritikon gjithashtu qeverinë për reduktimin e hapësirës së mbrojtur dhe ndërtimet mbi territorin e Parkut Kombëtar.

"Mbi të gjitha, duhet të shohim atë që propaganda nuk e tregon: të vërtetën", shprehet Tare.

Reagimi

Kino Ditari Butrinti, midis Propagandes dhe Realitetit"

Dje, në Instagramin e Kryeministrit, u shfaq një video propagandistike për Butrintin. Një seri pamjesh, me sa duket e përgatitur nga ekipi i AADF-së, (Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim) qe paraqiste disa ndërhyrje në Qytetin Antik dhe punët e kryera për infrastrukturen turistike.

Nuk është e pazakontë që Kryeministri i vendit, veçanërisht gjatë një vizite në Shtetet e Bashkuara, të mos ketë kohë të merret me hollësitë e një parku arkeologjik në skajin jugor të Shqipërisë dhe postimet ti beje ekipi i tij. Por, kur një material publikohet nga adresa e tij zyrtare, ai merr edhe përgjegjësi politike. Dhe pikërisht për këtë arsye, videoja më bëri të ndalem e të shkruaj disa rreshta mbi dallimin e vjetër midis propagandës dhe realitetit.

Pamjet e videos tregojnë disa punime që, në vetvete, mund të jenë të dobishme. Por tregojnë

ide!

Ish-shefja e SHISH, nuk shantazhoi median, por kërcënoi armiqtë e saj

Nga Lorenc Vangjeli

Rikthimi i SHISH-it në politikë si banalitë

Nga Mero Baze

Tej e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose [kliko këtu](#) për mënyra të tjera kontakti.



Moti

Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos

[Shiko të tiera video](#)

edhe diçka tjetër, një kullë venedikase të degraduar nga brenda, infrastrukture vizitoresh të dëmtuar, ambiente të lëna pas dore dhe një seri problemesh që nuk janë krijuar brenda natës.

Nëse gjendja e Butrintit ka qenë vërtetë kaq e rënduar sa paraqitet në video, atëherë kush mban përgjegjësi për dhjetë vitet e administrimit shtetëror që i paraprinë kalimit të administrimit tek fondacioni privat AADF?

Përgjegjësia administrative dhe politike bie, ndër të tjera, mbi qeverinë dhe ministrinë që kanë pasur në varësi Butrintin gjatë kësaj periudhe. Dy prej ministrave të Kulturës të kësaj periudhe ishin znj. Mirela Kumbaro Ministria e sotme e Arsimit dhe znj. Elva Margariti e zhytur në harrese publike.

Pra, videoja që synon të tregojë suksesin e administrimit të sotëm privat, pa dashje, tregon edhe dështimin e administrimit të djeshëm të shtetit drejtuar nga Kryeministri i sotëm.

Videoja fokusohet pothuajse tërësisht tek Qyteti Antik, por Parku Kombëtar i Butrintit, nuk është vetëm teatri, bazilika, akropoli dhe muret rrethuese.

Butrinti është një Park Kombëtar, një territor i gjerë natyror dhe arkeologjik, një peizazh kulturor i jashtëzakonshëm dhe një hapësirë që përfshin lagunën, zonat arkeologjike periferike, monumentet rurale dhe peizazhin historik.

Nëse duam të gjykojmë administrimin e Butrintit, nuk mund të shohim vetëm atë që ndodh brenda rrethimit të qytetit antik.

Duhet të shohim edhe atë që ndodh jashtë tij, e këtu propaganda bëhet veçanërisht selektive.

Sipas kritikave të ngritura prej kohësh nga Unesco dhe specialistet për ndryshimet në kufijtë e zonës së mbrojtur, një sipërfaqe e konsiderueshme e territorit të mëparshëm të mbrojtur është hequr nga mbrojtja. Kjo është një çështje që kërkon transparencë dhe një debat publik serioz. Kush e hoqi nga mbrojtja dhe çfarë arsyesh fshihen pas kësaj reduktimi të hapsirës së mbrojtur? As Kryeministri dhe askush deri më sot nuk kanë dhënë sqarim publik se përse janë hequr një sipërfaqe kaq e madhe nga Zona e Mbrojtur Shpallur pasuri Botërore e Unesco-s

Nderkohe kushdo mund të shkojë në këto zone dhe të shikojë se si e gjithë hapsira nga Ksamili deri në grykëderdhjen e Kanalit të Vivarit është e rrethuar me gardhe hekuri. Janë hapur rrugë me eskavator. Janë vendosur porta metalike dhe rojet nuk lejojnë askënd të kalojë në këto pjesë të Parkut të Butrintit përfshirë edhe zonën e Lagunes kjo e shpallur zone e mbrojtjes me statusin e Konventës së Ramsarit (mbrojtja e lagunave)

Nderkohe në pjesën lindore të Parkut ndodhet një pasuri arkeologjike që rrallë shfaqet në filmat promocionalë, totalisht e lënë pas dore dhe e braktisur nga çdo vëmendje institucionale.

Kalivo, vendbanimi i periudhës së bronzit.

Diaporiti, me vilën romake dhe kishën e shek IV-V.

Gjurmët e ujës-jellësit romak të shekujve I–II.

Peizazhe arkeologjike dhe historike që tregojnë se historia e Butrintit nuk përfundon tek porta e qytetit antik.

Këto janë pjesë e së njëjtës trashëgimi si Qyteti Antik. Por sa ekiye arkeologjike punojnë sot atje?

0

Sa projekte konservuese në rrenojat e Viles, Ujesjellesit, Bazilikes se fushes se Vrines? 0

Sa programe monitorimi në mbrojtjen e hapsirës ? 0

Sa investime të qëndrueshme ? 0

Sa vizitorë arrijnë t'i shohin? 0

Këto janë pyetje që nuk marrin asnjë përgjigje nga një video promocionale në adresën e Kryeministrit të Kosovës.

Dhe pastaj vjen Ksamil

Hyrja e Parkut Kombëtar nga ana e Ksamilit është një tjetër histori.

Në vend të një porte dinjitoze drejt një prej peizazheve më të rëndësishme kulturore të Mesdheut, kemi prej kohësh një vend ku biznesi lokal hedh prehrat perditë. Kane kaluar 3 vjet që nga informacioni në të gjitha hallkat e shtetit shqiptar për këtë turp dhe plehrat vazhdojnë të hidhen në hyrje të Parkut Kombëtar të Butrintit, Pasuri Botërore e UNESCO-s.

Nderkohe rruga e unazës së Ksamilit ka prekur territorin e zonës së mbrojtur dhe presioni i ndërtimeve mbi peizazhin e Butrintit është tashmë një çështje që nuk mund të fshihet pas imazheve të bukura të qytetit antik.

Zona përreth Diaporit, Liqenit të Buftit dhe Kalivos ndodhet përballë presionit të zhvillimit turistik ku po planifikohen ndërtime resortesh. Ashtu siç po planifikohet edhe në hapësirat bregdetare nga Kato Ajto drejt Gjirit të Fteles të gjitha këto pjesë e Zonave të Mbrojtura

Në Kino Ditarin e hedhur për konsum publik shfaqen disa pamje konservuese por ndoshta vete Kryeministri nuk e di se në Butrint nuk ka me një ekip profesionist restauratorësh si dikur kur ai vete ishte Ministri i Kulturës. Konservimi i disa mureve në Butrint me gelqere supermarkatesh është trishtimi më i thellë i gjithë kësaj farse konservuese.

Nderkohe sipas të dhënave publike të vizitueshmërisë, Butrinti pret qindra mijëra vizitorë, por ende sot parku nuk ka guidë profesionale. Ashtu siç nuk ka një forcë të sigurimit të territorit si dikur të trajnuar edhe nga institucione ndërkombëtare por ka një firmë private e cila ka mbledhur disa pleq në prag pensioni për të mbrojtur hapsirën e qytetit arkeologjik.

Nderkohe që Kino Ditarin i propagandës tregon pamje të bukura nuk arrin të përgjigjet një pyetje shumë të thjeshtë.

Sa para gjeneron Butrinti dhe ku shkojnë ato para?

Nëse të ardhurat vjetore nga vizitorët dhe aktivitetet e lidhura me parkun arrijnë në miliona euro, atëherë standardi i administrimit duhet të matet jo me një video Instagrami, por me rezultatet në terren. Me restaurimin e monumenteve. Me mbrojtjen e territorit. Me konservimin e monumenteve të demtuara nga koha. Me projektet për komunitetin. Me aksesin publik. Me kërkimin shkencor. Me profesionalizmin e stafit.

Dhe në fund të videos shfaqet edhe qendra e artizanatit.

Një ide që, në fakt, nuk është e re. Ajo lidhet me përpjekjet e mëparshme për të integruar komunitetin lokal në ekonominë e trashëgimisë që në kohën kur Kryeministri i sotëm ishte administrator i Kulturës Kombëtare.

Por mjafton të flasësh me njerëzit që merren prej më shumë se njëzet vitesh me artizanatin në Butrint për të kuptuar se fotografia në ekran nuk është domosdoshmërisht fotografia në terren.

Sa prej tyre janë mbështetur realisht? 0

Sa prej tyre kanë përfituar nga fondet që gjeneron Butrinti? 0

Sa prej tyre janë përfshirë në mënyrë të qëndrueshme në ekonominë e parkut? 0

Këto janë pyetje shumë më interesante sesa një pamje e bukur e një tezge artizanale.

Problemi nuk është nëse Fondacioni privat AADF ka restauruar një kullë, ka rregulluar një shteg apo ka investuar në një ndërtesë.

Problemi është tjetër. Kuji i përket përfundimisht Butrinti? Një Qytet Antik që administrohet

nga te huaj dhe ku Kontrolli i Shtetit nuk ka asnje te drejte te shikoje se cfare behet me parate e gjeneruara nga ky Park.

Parku Kombëtar i Butrintit sot është shembulli më i qartë i mënyrës se si shteti shqiptar ia ka dorëzuar administrimin e një prej pasurive të tij më të çmuara një strukture private e cila ka lidhje politike në Uashington. Por a është ky një justifikim moral? mendoj jo. Butrinti duhej te ishte modeli me i mire se si shqiptaret dine te administrojne pasurite e tyre kombetare. Duhej te ishte Shkolla Shqiptare e Administrimit dhe Jo një instrument të influencës politike personale.

Prandaj ne Kino Ditarin "sa mire behen punet ne Butrint" e hedhur per publikun mbi të gjitha, duhet të shohim atë që propaganda nuk e tregon. TE VERTETEN



Auron Tare

11 orë më parë



"Kino Ditari Butrinti, midis Propagandes dhe Realitetit"

Dje, në Instagramin e Kryeministrit, u shfaq një video propagandistike për Butrintin. Një seri pamjesh, me sa duket e përgatitur nga ekipi i AADF-së, (Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim) qe paraqiste disa ndërhyrje në Qytetin Antik dhe punët e kryera për infrastrukturën turistike.

Nuk është e pazakontë që Kryeministri i vendit, veçanërisht gjatë një vizite në Shtetet e Bashkuara, të mos ketë kohë të merret me h...
Shiko më shumë



INSTAGRAM

MIRËMËNGJES 😊 dhe nga Butrinti magjik, ku çdo ditë pu...

70 6 72

AKTUALITET / 27 September 2026, 14:18

Nuk kapi frenat e dorës,
makina rrëshqet dhe e zë
poshtë, humb jetën 44-vjeçari
në Maliq

AKTUALITET / 27 September 2026, 12:55

Ish-deputeti Azgan Haklaj
ndalohet në kufirin e Bllatës,
Maqedonia e Veriut e ka futur
në "Stop-listë"

AKTUALITET / 27 September 2026, 12:20

"A do të lajmërojë dorëheqjen
Rama?", Salianji: Në New York

AKTUALITET / 27 September 2026, 11:35

U arrestua me urdhër të SPAK,
GJKKO lë në burg Bledar

pamë edhe një tjetër realitet,
braktisjen politike dhe
diplomatike të tij

Cafin, akuzohet si pjesë e një
grupi të trafikut të drogës

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.